



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prudato Received/Deliverty	21.12	2021	1	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	6254/2021		1/7	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.947/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1007/19 të datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.168/2019 të datës 06.03.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Qamil Ilazi”, Nr. 238 në Komunën e Kaçanikut, kundër Vendimit me numër 01-104/02-3278 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.168/2019 të datës 06.03.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-104/02-3278 i datës 27.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut dhe Vendimi me numër 01Nr.104/02-2727/19 i datës 30.01.2019 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Kaçanikut.

Arsyetim

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Kaçanikut në bazë të Akt Emërimit të datës 26.11.2012 në pozitën “Përgjegjës i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, më datë 09.01.2019 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore për mungesë të paarsyeshme në punës për datë 03.01.2019, 04.01.2019, 08.01.2019 dhe 09.01.2019, mirëpo më datë 11.01.2019 ka përmirësuar iniciimin e procedurës disiplinore duke theksuar që ankuesi ka

munguar në punë pesë (5) ditë duke shtuar edhe datën 10.01.2019. Më datë 11.01.2019 Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka paraqitur kërkesë numër 2 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për sjellje dhe fyerje ndaj Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Menaxherit të Zyrës së Prokurimit, Zyrtarit për Urbanizim dhe Zyrtarit për Ndërtim sipas shkresës së datës 28.06.2018 dhe 10.12.2018. Më datë 11.01.2019 Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka paraqitur kërkesë numër 3 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për zhvillimin e procedurës së kundërligjshme për pajisjen me lejë ndërtimit nga data 26.01.2016 deri më datë 09.02.2016, po ashtu më datë 16.01.2019 Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka paraqitur kërkesë numër 4 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për fyerje sipas shkresës me numër 01Nr.104/02-1280/2019 të datës 15.01.2019, ndërsa më datë 15.01.2019 Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Kaçanikut ka kërkuar nga Zyra e Personelit e Komunës së Kaçanikut se të gjitha kërkesat e procedurës disiplinore të bashkohen duke përfshirë që vlerësimi për dy vitet e fundit është me notën 1 (njësh).

Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut më datën 30.01.2019, ka nxjerr Vendim me numër 01Nr.104/02-272/19 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ***“Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”***.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 01Nr.104/02-272/19 të datës 30.01.2019 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kaçanikut, me datë 05.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër 01-104/02-3278/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Kaçanikut.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut, me datë 27.02.2019 ka nxjerrë Vendim me numër 01-104/02-3278 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 01-104/02-3278 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut, brenda afatit ligjor konform Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2019 parashtron ankesën me numër protokollit 1185/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 12.03.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit, e ka proceduar tek Komuna e Kaçanikut. Me datë 28.03.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kaçanikut me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 24.04.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së datës 06.03.2019.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1007/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit

të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 24.04.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 06.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 1185/2019 të datës 06.03.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-104/02-3278 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut; Ankesën e datës 05.02.2019 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut; Vendimin me numër 01Nr.104/02-272/19 të datës 30.01.2019 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kaçanikut; E-mailin e datës 17.01.2019 nga [] për ankuesin; Kërkesën për vazhdimin e pushimit vjetor për vitin 2018 e datës 26.12.2018 nga ankuesi për Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Kërkesën për pushim vjetor prej datës 03.01.2018; Kërkesën për pushim vjetor e datës 29.10.2018; Vendim mbi heqjen e mëditjes i datës 12.07.2017; Vendim me numër 01-112-23034/2017 i datës 03.08.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut; Deklaratën datës 28.01.2019 të ankuesit për Kryetarin e Komisionit Disiplinor; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 09.10.2019; Vendim për përmirësim të iniciimit të procedurës disiplinore të datës 11.01.2019; Kërkesën Nr.2 për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 11.01.2019; Kërkesën Nr.3 për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 11.01.2019; Kërkesën Nr.4 për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 16.01.2019; Shkresën e datës 11.01.2019 nga [] dhe [] për Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Lejen Ndërtimore me Nr. 351-3432/16 e datës 09.02.2016; Aplikacion për leje ndërtimore; Kopja e Planit datë 22.01.2016; Certifikatë e datës 22.01.2016; Akt pajtimin me Nr. 01-104/02-31295/17 i datës 05.10.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2018 për ankuesin; Ankesën e datës 30.01.2019 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018; Vendimin me Nr. 06-104/02-2763 i datës 22.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut; Akt Emërimit e datës 26.11.2012 të ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.01.2018 për ankuesin; Listën e vijueshmërisë në punë për datën 03, 04, 08, 09 dhe 10.01.2019; Fletë dorëzimi i datës 28.02.2019; Procesverbali i datës 12.20.2019 dhe 27.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën e datës 15.01.2019 nga Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për Kryetarin e Komunës së Kaçanikut; Kërkesën e datës 16.01.2019 nga Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për Menaxheren e Personelit; Sqarimin e datës 16.01.2019 nga []

Përgjigje e datës 16.01.2019 nga [] Kërkesë për rishqyrtimin e vlerësimit e datës 15.01.2019 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Kaçanikut; Shkresën e datës 28.06.2018 dhe 10.12.2018 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Kaçanikut; E-mail i datës 15.01.2019 nga [] Procesverbalet e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 21.01.2019, 22.01.2019, 23.01.2019; Deklaratën e datës 24.01.2019 nga [] E-mailin e datës 31.01.2019 nga [] për ankuesin; Fletë dorëzimin e datës 31.01.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 28.03.2019; Njoftimin e datës 24.04.2019; Kërkesën e ankuesit e datës 23.04.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1007/19 të datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka respektuar nenin 6 të Rregullores Nr. 05/2011 pasi që nuk është angazhuar për zgjidhjen e kontestit për arritjen e kompromisit; Vendimi i Komisioni Disiplinor është mbështetur në nenin 64, 67 dhe 71 por nuk është mbështetur në asnjë nen të rregulloreve të cilat i ka përshkruar në preambulë; Nuk janë marr parasysh atë që kjo nuk ka qenë shkelje e qëllimshme nga unë sepse mos prezenca ime nuk ka shkaktuar ndonjë dëm pasi që kërkesa ime ka qëndruar në Zyrën e Personelit dhe pse nuk është procedura për nënshkrim duke mos u njoftuar nga Zyra e Personelit apo drejtori i drejtorisë; Vendimi i Komisionit Disiplinor dhe i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka respektuar nenin 6 të Rregullores Nr. 05/2011 pasi që nuk është angazhuar për zgjidhjen e kontestit për arritjen e kompromisit, ka konstatuar që në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave është përcaktuar që akt pajtimi bëhet në pajtim me nenin 52 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative ndërsa i njëjti ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka pas bazë ligjore për arritjen e një kompromisi pasi që rasti i ankuesit ka qenë mungesa në punës për pesë (5) ditë e cila ka qenë e paarsyetuar dhe e njëjta konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Vendimi i Komisioni Disiplinor është mbështetur në nenin 64, 67 dhe 71 por nuk është mbështetur në asnjë nen të rregulloreve të cilat i ka përshkruar në preambulë, ka konstatuar që Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01Nr.104/02-2727/19 të datës 30.01.2019, ka arsyetuar saktë bazën ligjore dhe ka shqyrtuar saktë provat e lëndës duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike sepse ka përdorur dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe dispozitat e akteve tjera nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që nuk janë marr parasysh atë që kjo nuk ka qenë shkelje e qëllimshme nga unë sepse mos prezenca ime nuk ka shkaktuar ndonjë pasojë pasi që kërkesa ime ka qëndruar në Zyrën e Personelit dhe pse nuk është proceduar për nënshkrim duke mos u njoftuar nga Zyra e Personelit apo Drejtori i drejtorisë, ka konstatuar që ankuesi ka përgatitur kërkesën për pushim vjetor nga data 03.01.2019. mirëpo në bazë të provave të lëndës të njëjtën kërkesë nuk e ka paraqitur tek udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë për miratim dhe nënshkrim kjo mund të konstatohet edhe në bazë të deklarimeve të ankuesit në seancën e Komisionit Disiplinor të datës 21.01.2019 i cili në pyetjen e Kryetarit të Komisionit Disiplinor është përgjigjur se: ***“kërkesa është dorëzuar Menaxheres së***

personelit znj. për arsye të raporteve siç dihet se si janë mes udhëheqësit të drejtpërdrejtë”, ndërsa znj. pyet ankuesin se: “... pse ke dërguar kërkesën për pushim tek menaxherja e personelit pa e nënshkruar nga udhëheqësi kur të gjithë e dijnë se në zyrën e personelit dërgohen kërkesat e nënshkruara nga udhëheqësit tan dhe futen në dosje të zyrtarëve”, ndërsa ankuesi përgjigjet: kërkesa është dërgu tek

për shkak të raporteve me drejtorin, gjithherë e kam ndëshkru tek Kryetari apo Nënkyetari por këtë herë nuk kishin qenë aty dhe e dërgova tek dhe u morrem vesh që a dërgon tek kryetari apo Nënkyetari për nënshkrim...”, mbi këtë bazë Kolegji për

shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që nëpunësit civil (ankuesi) lidhur me pushimet vjetore janë të obliguar ti respektojnë procedurat e parapara me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, që përcaktojnë se: “Nëpunësit civilë paraqesin kërkesë (shtojca nr.1 e kësaj rregulloreje) te udhëheqësi i tyre, së paku tri (3) ditë pune para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 5 të kësaj Rregulloreje” paragrafi 2 “Kërkesa e miratuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil i dërgohet menaxherit të personelit, për ta përfshirë në dosjen personale të nëpunësit”, kështu që edhe pse ankuesi ka përgatitur kërkesën për pushim prej datës 03.01.2019 i njëjti kërkesën nuk e ka dërguar tek udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt por këtë e ka dërguar tek Menaxherja e Personelit duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura. Në këtë rast ankuesi pa pasuar miratimin e kërkesës për pushim vjetor nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, i njëjti nuk është paraqitur në vendin e tij të punës për datat 03.01.2019, 04.01.2019, 08.01.2019, 09.01.2019 dhe 10.01.2019, kjo konstatohet edhe nga vijueshmëria në punë duke mos njoftuar udhëheqësin e drejtpërdrejt të tij për mungesë në punë, kështu që me këto veprime ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “Nëpunësit civilë janë të detyruara t’i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mosinformimi ose mungesa e pa lajmëruara nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin” dhe nenin 7 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 05/2012 e Orarit të Punës, i cili përcakton se: “Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, nëpunësi civil duhet të marr leje nga menaxheri drejtues”. Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstatoi se ne baze të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nëpunësit civilë kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për pushim vjetor, ne rastin konkret ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë pushim vjetor, mirëpo nuk ka pasur të drejtë të shkoj në pushim vjetor pa miratimin e udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që veprimet e ankuesit për mungesë nga punë pa njoftim paraprak dhe pa miratim të kërkesës janë shkelje të dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe në bazë të dispozitave të nenit 63, 64, 65, 66 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civil respektivisht ankuesi është përgjegjës për veprimet e tij duhet t’u nënshtrohet procedurave disiplinore sipas dispozitave të lartcekura, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01Nr.104/02-2727/19 të datës 30.01.2019 me të cilin ka konstatuar se ankuesi ka munguar në punë pa arsye, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 66 paragrafit 1 dhe 4 nën paragrafit 4.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor.4. Për shkelje të rënda-serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim: 4.3. ndërprerja e marrëdhënies së punës

në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor”, si dhe në pajtim me nenin 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil sepse mos informimi dhe mungesa e paarsyeshme në punë për dy ditë të njëpasnjëshme është shkelje e rëndë serioze e përcaktuar me dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.13 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: “Shkelje të rëndësioze, konsiderohen: mosinformimi dhe mungesa e paarsyeshme për dy (2) dite punës të njëpasnjëshme”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që ankuesi më datë 15.01.2019 tek Kryetari i Komunës së Kaçanikut ka dërguar ankesë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2018 respektivisht kërkesë për rishqyrtimin e vlerësimit me numër 06Nr.104/02-1280/2019 në të cilën përveç kundërshtimeve lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, ka përdorur gjuhë fyese dhe paragjykuese ndaj udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë, por Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse ankuesi lidhur me pakënaqësinë për vlerësimin e rezultateve në punës, më datë 30.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut më datë 22.02.2019 ka nxjerr Vendim me numër 06-104/02-2763 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit e datës 30.01.2019, në kuptim të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konsideron që kjo pjesë është e vendosur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, respektivisht shkresës së datës 11.01.2019 të Zyrtarit për Urbanizëm dhe Zyrtarit për Ndërtim në të cilën theksohet që: *“me anë të kësaj shkrese shprehim shqetësimin tonë, tek drejtori i DUKMM-së , z. [emri i fshehtë] pasi që kemi hasur në një shkresë (shkresa me numër 01Nr.104/01-39482/18 të datës 10.12.2018) e dërguar nga përgjegjës i DUKMM-së z. [emri i fshehtë] në të cilin shkresë emrat tanë janë lakuar, duke na quajtur “spekulues” pa as edhe një argument të vetëm...duke patur parasysh faktin se në z. [emri i fshehtë] kemi udhëheqës mendojmë se nuk është e drejtë të na trajtojë dhe shprehet ndaj nesh në formën siq është shprehur në shkresën e sipërpërmendur”,* po ashtu duke pas parasysh edhe shkresat e tjera të datës 16.01.2019 të zyrtarëve të tjerë të cilët kanë dërguar shkresë për Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Kaçanikut me të cilat kanë theksuar që ankuesi

nuk ka pranuar bashkëpunim. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi bazë të këtyre provave, ka konstatuar se ankuesi përveç që nuk ka bashkëpunuar me Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit si udhëheqës të drejtpërdrejt nuk ka bashkëpunuar as me zyrtarët që i përgjigjen ankuesit, me ç’rast veprimet e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 51 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 5, 10 dhe 11 të Rregullores (QRK)-Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01Nr.104/02-2727/19 të datës 30.01.2019, dhe shqiptimit të masës disiplinore, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregullores (QRK)-Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.947/2021

Avdyli BEKTESHI

Bekteshi
Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit,*
- *Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;*
- *Z. Fisnik Nuli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kaçanikut;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*